



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.
(komision për dhënie mendimi)

2. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

(komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Silva Caka, Elena Xhina, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Renata Balliu - Nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Ernest Dimashi - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ylli Kumria - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Zyhdi Mema - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përsëndetje!

Meqenëse kuorumi për fillimin e mbledhjes është plotësuar, fillojmë mbledhjen e ditës së sotme! Sot kemi 2 çështje në rendin e ditës.

Si pikë të parë e rendit të ditës, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Relatore është kolegja Elena Xhina. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Brendshme: znj. Rovenë Voda, zëvendësministre; znj. Renata Balliu, nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit zotërinjtë: Ernest Dimashi, Ylli Kumria dhe Zyhdi Mema.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Fillojmë prezantimin e marrëveshjes së parë. I jap fjalën zëvendësministres, Rovenë Voda. Ju lutem, shkurtimisht dy fjalë për marrëveshjen!

Rovenë Voda – Besoj se e shihni edhe në relacionin bashkëngjitur projektligjit, se kjo është një marrëveshje, e cila ka për qëllim instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal në pikat tona të kontrollit kufitar dhe, në aeroportin e Rinasit, pajisjen komplementare të sistemit TIMS, i cili do të bëjë identifikimin e rasteve me rrezikshmëri të lartë. Pra, mendoj se është një vlerë në kuadër të sigurisë sonë në pikat e kontrollit kufitar.

Këto pajisje do të mirëmbahen nga qeveria e SHBA-së. Kështu, do të jenë ata, që do ta mirëmbajnë sistemin. Mendoj se është një vlerë e shtuar. Të gjitha institucionet e kanë kaluar në konsultimin e brendshëm dhe kanë qenë dakord. Kishin vetëm disa propozime për disa gjëra të vogla teknike. Ky akt ka për qëllim shtimin e sigurisë në kontrollin tonë kufitar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Fjalën e ka relatorja, kolegja Xhina!

Elena Xhina - Faleminderit, zoti kryetar!

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Siç u theksua, ka të bëjë me forcimin e kontrollit në kuadër të luftës kundër terrorizmit, duke vendosur disa sisteme dhe pajisje shtesë. Pajisjet e sistemit do të sigurohen nga qeveria e SHBA-së. Pra, ne nuk do të kemi kosto financiare.

Rovena Voda – Jo, sepse këto pajisje do të mirëmbahen nga qeveria e SHBA-së.

Elena Xhina - Në këto kushte, duke qenë se ky projektligj është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, ka ardhur në mënyrën e duhur në komision dhe është në përputhje edhe me Kushtetutën, sugjeroj të miratohet nga kolegët.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Ka pyetje nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Sa është vlera e gjithë projektit?

Rovena Voda – Si vlerë?

Ulsi Manja – Po, zoti Braho pyet se sa është vlera e gjithë projektit.

Rovena Voda – Në lidhje me këtë, ia kaloj fjalën drejtorit të IT-së, zotit Ernest, që ka punuar me ekspertët amerikanë, të cilët do ta instalojnë pajisjen.

Ernest Dimashi – Vlera e saktë e donacionit është 5 milionë dollarë, prej të cilave nëse mund ta detajoj, një pjesë do të shkojë për pajisjen, pjesa tjetër shkon për konfigurimin dhe për mirëmbajtjen.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Kisha edhe unë një pyetje. Sistemet që kemi aktualisht në pikat e kalimit kufitar apo edhe në Rinas, do të dalin nga funksionimi, apo do të jenë dhe do të shtohen edhe këto?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rovena Voda – Atë do të jenë dhe do të shtohen edhe këto elemente.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë në votim!

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Sugjerimin e kolegut Çuçi për një ndryshim të vogël në titullin e projektligjit, do t'ia bëjmë komisionit përgjegjës.

Para se të kaloj në pikën e dytë të rendit të ditës, gjej rastin të falënderoj qeverinë amerikane për këtë marrëveshje, që është në vazhde të shumë projekteve që ka financuar qeveria e SHBA-së në fushën e rendit dhe të sigurisë publike. Shpresoj që qëllimet e mira të kësaj marrëveshjeje të zbatohen me korrektësi nga ana e autoriteteve shqiptare.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

(komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Silva Caka, Elena Xhina, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Renata Balliu - Nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Ernest Dimashi - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ylli Kumria - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Zyhdi Mema - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ulsi Manja – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, te shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”. Relator është kolegu Çyrbja. Komisioni ynë është edhe për këtë projektligj përsëri komision për dhënie mendimi.

Pjesëmarrësit nga Ministria e Brendshme dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i konfirmova në fillim të mbledhjes.

Fjala për ju, zonja zëvendësministre, për të bërë një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje!

Rovena Voda - Kjo marrëveshje duket sikur vjen në kohë dhe plotëson në kuadër të të gjitha marrëveshjeve që kemi me pjesën më të madhe të vendeve të BE-së për rikthimin e personave me qëndrim të paautorizuar në këto vende. Ajo është një vlerë e shtuar në luftën kundër migracionit të paligjshëm, i cili është një fenomen shqetësues jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë Europën. Kemi një marrëveshje mëmë, një marrëveshje kuadër me BE-në dhe më pas, këto lloj marrëveshjesh i kemi me të gjitha vendet. Pra, janë marrëveshje bilaterale bashkëpunimi, siç i kemi edhe me Francën, edhe me Italinë, edhe me Gjermaninë.

Spanja ishte një ndër vendet e fundit me të cilën ne nuk kishim një marrëveshje të tillë dhe është në këtë protokoll bashkëpunimi, ku përcaktohen pikat e kontaktit, plotësimi i formularëve, si do të bëhet kthimi. Përgjegjës është Departamenti për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Unë mendoj se është një vlerë e shtuar pikërisht në kuadër të kësaj lufte kundër fenomenit të migracionit të paligjshëm.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Fjalën e ka relatori!

Jurgis Çyrbja - Projektligji ka si qëllim lehtësimin e zbatimit të marrëveshjes, ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar.

Gjykoj se ky projektligj është në përputhje të plotë me Rregulloren e Kuvendit dhe me Kushtetutën. Në këto kushte, ju ftoj ta votojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Kush ka pyetje?

Urdhëroni, zonja Caka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rovena Voda - Në fakt i referohemi të dhënave të EUROSTAT-it.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... Informacioni nga Departamenti i Kufirit.

Zoti Kumria, mund t'i përgjigjeni deputetes!

Ylli Kumria – Lidhur me statistikat, ne kemi një panoramë, e cila normalisht është një trend në rritje. Nëse i referohemi vitit të kaluar që ka qenë viti 2017...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Ju japim shifrat. Në këtë vit (2017) kanë qenë 61 persona të kthyer nga Spanja. Momentalisht (për këtë 6-mujor), janë 66 persona. Duke parë këtë lëvizje, këtë trend, normalisht edhe këto protokolle në zbatim, bëhen për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po flasim për azilkërkues, por po flasim për persona, që janë me qëndrim të parregullt në territor. Pra, s'po flasim për persona me statusin e azilkërkuesit. Të gjithë këta persona janë të kthyer. Ne nuk kemi informacion lidhur me faktin nëse janë azilkërkues, apo nuk janë, sepse ky informacion nuk ndahet me ne nga autoriteti përkatës. Ju e dini se konventa për refugjatët nuk i lejon të ndahet ky informacion me shtetin përkatës.

Vasilika Hysi – Ne kemi ratifikuar marrëveshjen në vitin 2006 dhe protokollin me Spanjën vjen në vitin 2018. Si është operuar, ndërkohë dhe, a ka shtete të tjera me të cilat ne kemi nevojë të kemi protokolle për modalitetet e ripranimit të personave me qëndrim të paautorizuar?

Rovena Voda - Pyetja juaj është e drejtë. Në fakt, para se të shkonim në këtë protokoll, është operuar me marrëveshjen kuadër, pra me marrëveshjen që ne kemi me BE-në. Kemi marrëveshje edhe me vendet e tjera, madje është me një nga vendet fqinje, si Greqia. Jemi në biseda, në negociata me të për të nënshkruar edhe protokollin me Greqinë për modalitetet e ripranimit të personave me qëndrim të paautorizuar.

Bashkim Fino – A mund të bëj një pyetje?

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Po me vendet e tjera të Europës përveç Spanjës?

Rovena Voda - Kemi edhe me Francën, me Greqinë dhe ndoshta edhe me ndonjë vend tjetër, por me pjesën më të madhe janë nënshkruar. Pra, është në vazhden e protokolleve që kemi bërë me vendet e BE-së apo atyre të zonës shengen.

Bashkim Fino – Ideja ime, zoti kryetar, është që këtë protokoll ta nënshkruajmë me të gjitha vendet e Europës. Pra, të kërkojmë që edhe me vendet e tjera të Europës që kemi të panënshkruara këto protokolle, t'i nënshkruajmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e di edhe sa kemi akoma pa nënshkruar.

Rovena Voda - Kanë mbetur shumë pak.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

I lutem sekretarisë, që të 2 projektligjet së bashku me relacionet përkatëse dhe me sugjerimet e bëra nga kolegët, t’i përcillen komisionit përgjegjës për t’i kaluar më pas në seancë plenare. E mbyllim këtu mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t’ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA